



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2015
Nr. Dok. 201500347/3

Lënda: *Rekomandohet vendosja e kamerave në koridorin e bokseve të ajrimit në IEVP 302 si dhe korigjimi i sistemit të regjistrimit të pamjeve në kamerat ekzistuese*

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur ZOTO

TIRANË

Për dijeni: Drejtorit të IEVP në Rrugën "Mine Peza"
Z. Fatjon FANAJ

TIRANË

I nderuar Zoti Zoto,

Në zyrën e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e të paraburgosurit I. K., i cili pretendon se në datën 02.03.2015, është dhunuar fizikisht nga punonjës të policisë të IEVP 302. Sipas I. K., ai është goditur fillimisht me grushta në koridorin e bokseve të ajrimit dhe më pas në dhomën e veçimit pasi ka përshëndetur të paraburgosurin D. D., komunikimi me të cilin është i ndaluar nga institucioni.

Një nga veprimet e kryera për verifikimin e kësaj ankese ishte njohja me pamjet filmike të kamerave të sigurisë. Nga ky veprim u konstatua se, në koridorin e bokseve të ajrimit, ku pretendohet se ka ndodhur goditja e parë ndaj I. K. nuk kishte kamera të sigurisë. Në ambjentet e ajrimit kishte një kamera që kapte vetëm pamje të dy bokseve të para të ajrimit. Gjithashtu nga kqyrja e pamjeve filmike rezultoi se, kamerat nuk regjistrojnë pamje kur nuk kishte lëvizje të personave si dhe në disa fragmente kishte kapërcime të pamjeve me disa sekonda.

Mbikqyrja me kamera e të gjitha ambjenteve në IEVP, përveç atyre ambjenteve që çënojnë privatësinë, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambjenteve të burgje dhe paraburgime, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

1. Vendosjen e kamerave që të monitorojnë koridorin e bokseve të ajrimit në IEVP 302;

2. Korigjimin e sistemit të regjistrimit të pamjeve në mënyrë që pamjet e ambjenteve të regjistrohen gjatë gjithë kohës pavarësisht nëse ka lëvizje ose jo dhe të mos ketë kapërcime të sekuencave me disa sekonda.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nein 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI